



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241282

Datë: 18.01.2024

Numri i dokumentit: 05208504

**AC-I-23-0076**

***Në ankesën e***

***Paditësi***

**J F**, i përfaqësuar nga avokati **B I**, nga Prishtina.

***Kundër***

***E paditura/Ankuesja***

**NSH "Magjistratja"** Prishtinë (në likuidim), përfaqësuar nga, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1613, të datës 18 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 18 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1613, i datës 18 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datë 10 korrik 2013, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-së një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN032-0100, të datës 31 maj 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensim të pagave të pa paguara, për periudhën janar 2006- prill 2007, në shumë prej 6,272.64 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka kryer asnjë shërbim pune dhe nuk ka qenë në listën e pagave për ndërmarrjen për periudhën e cekur. Kjo ankesë ishte grupore dhe ishte regjistruar me numër fillestar C-IV-13-1216. Pastaj pas urdhrorit të Gjykatës, paditësi e dorëzoi një parashtrësë për rregullimin dhe plotësimin e padisë e cila u regjistrua si ankesë dhe ka marrë numrin C-IV-15-1613. Paditësi në ankesë pohon se Autoriteti i Likuidimit nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike pasi që ai pohon se e kishte pranuar letër pezullimin nga AKM-ja, me të cilën dëshmohet se ai ka punuar deri me 22 maj 2007. Tutje paditësi pohon se NSH-ja e paditur ishte obliguar ti paguaj pagat për periudhën e cekur. Paditësi në ankesë ka kërkuar që të aprovohet ankesa dhe atij ti njihet e drejta e kompensimit të pagave të papaguara. Me këtë ankesë paditësi ka kërkuar edhe kamatën ligjore si dhe shpenzimet e përfaqësimit. Me ankesë paditësi ka dorëzuar Autorizimin e Avokatit, kopjen e Letërnjoftimit dhe Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 21 shtator 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pretendon se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat materiale. AKP-ja pohon se ankesa është e pa pranueshme pasi që është paraqitë pas afatit, dhe është pa asnjë verë ligjore. Tutje pohon se parashtrësja për rregullim dhe plotësim të padisë për veq që është e pa pranueshme, ajo nuk bazohet në gjendjen faktike të vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit. AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit ka kompetencë të vlerësoj se paga është një e drejtë që buron nga marrëdhënia e punës për punën e kryer, ndërsa paditësi nuk mund të vlerësohet se ka kryer ndonjë punë për NSH në periudhën e cekur, andaj nuk mund të pretendon paga ndaj NSH-së. Tutje AKP-ja pohon se lista e 20% nuk ka asnjë ndikim lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja me mbrojtje në ankesë ka bashkangjitur, vendimin e ankimuar

të Autoritetit të Likuidimit, Fletë kthesën e pranimi të vendimit të Autoritetit të Likuidimit, dhe Vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 04 tetor 2017, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet e AKP-së, ndërsa i përsëritë pretendimet e veta të cekura në ankesë.

Me datë 25 tetor 2017, AKP-ja e dorëzoi kundërpërgjigjen, në të cilën ajo pohon se paditësi nuk ka punuar në NSH dhe se ai nuk ka të drejtë në paga të pretenduara ndaj NSH-së. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 20 qershor 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshon një Urdhër për paditësin nga i cili kërkohet të dërgoi prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 08 korrik 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Bashkë me këtë parashtresë paditësi ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 13 prill 2007, formularin e kërkesës, Listat të pagave të punëtorëve të pa paguara për periudhën janar 2006- prill 2007, një akt përcjellës të Drejtorit të NSH-së për dërgimin e Listës së pagave në Zyrën rajonale të AKM-së, Deklaratë nën Betim të Drejtorit të NSH-së, kopja e letërnjoftimit, kontrata e punës së Drejtorit të NSH-së, një Referencë, dhe një Regjistër të punëtorëve.

Me datë 27 korrik 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj parashtresës së fundit të paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i përsërit pretendimet e veta të cekura në mbrojtje në ankesë, dhe ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar.

Me datë 18 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1613, ankesën e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN032-0100 të datës 31 maj 2013, dhe e obligon Autoritetin e Likuidimit që në emër të pagave të papaguara për periudhën janar 2006-prill 2007 ti paguaj paditësit shumën prej 3,016.13 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 301.61 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 134,00 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj

në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar e ka refuzuar si të pa bazuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk qëndron pretendimi i AKP-së se ankesa është e paafatshme. Nga fletë dorëzimi të cilën e ka ofruar si provë vet e paditura, shihet se paditësi Vendimin e ankimit të Autoritetit të Likuidimit e ka pranuar me datë 10 qershor 2013, ndërsa ankesa grupore ndaj këtij vendimi është dorëzuar me postë me datë 03 korrik 2013. Tutje shkalla e I-rë konstaton se paditësi ishte i punësuar në NSH Magjistratja, mirëpo çështje kontestuese ndërmjet palëve ka mbetur se a ka ofruar shërbime pune paditësi për NSH-në për periudhën janar 2006-prill 2007. AKP-ja pretendon se paditësi nuk ka qenë në listën e pagave dhe nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në, ndërsa paditësi pretendimin e tij në paga e mbështet në përmbledhjen mujore të pagave për periudhën janar 2006-prill 2007, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Deklaratën e dhënë nën betim të ish Drejtorit të NSH-së si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë. Tutje shkalla e I-rë konstaton se në bazë të provave të ofruara vërtetohet fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune në NSH prej 01 mars 1996 e deri me 13 prill 2007, kohë kur ka filluar likuidimi i NSH-së. Ky fakt vërtetohet edhe nga Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, të cilën paditësi e ka ofruar si provë. Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të përmbledhjes së pagave mujore për periudhën janar 2006-prill 2007, e nënshkruar nga drejtori dhe llogaritari i NSH-së, lartësia e shumës në emër të pagave në bazë të listave mujore të pagave, duhet të jetë në shumë prej 3,016.13 euro. Tutje shkalla e I-rë konstaton se Drejtori i NSH-së Sh Sh dhe llogaritari i NSH-së A K në Deklaratën nën betim, kanë deklaruar se nën përgjegjësin e plotë morale, penale, dhe materiale ata kanë qenë kompetent dhe kanë nënshkruar listën e pagave të papaguara, dhe se ata janë të gatshëm në çdo kohë të dëshmojnë në të gjitha institucionet se këto lista të pagave paraqesin gjendjen e saktë të detyrimeve ndaj punëtorëve tek të gjitha njësit e NSH "Magjistratja". Andaj duke u bazuar në këto prova shkalla e I-rë konstaton se paditësi në periudhën janar 2006-prill 2007 ka ofruar shërbime pune për NSH-në dhe se NSH-ja i ka mbetur borxh paditësit në shumë prej 3,016.13 euro, ndërsa e paditura nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e saj që është vërtetuar. Tutje shkalla e I-rë konstaton se bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësit i është njohur edhe interesi ligjor prej 10%, në shumë prej 301.61 euro, që bashkë me borxhin kryesor duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Me datë 10 shkurt 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1613 të datës 18 janar 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se me Aktvendimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. AKP-ja pohon se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes nuk ka marrë parasysh faktin se paditësi nuk ka qenë në Listën e pagave për periudhën e cekur. AKP-ja pohon se në bazë historikut të llogarisë së paditësit të siguruar nga Banka Ekonomike del që paditësi, nuk rezulton të jetë në Listën e pagesave, andaj paditësi nuk ka ofruar shërbime pune në NSH dhe nuk ka qenë në listën e pagave. Nga këto arsye paditësi nuk ka arritur të provojë me fakte meritën e kërkesës së tij. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se paditësi nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur, duke pohuar se DHPGJS-ja ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 05 prill 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi pretendon se Aktvendimi i ankimuar është marrë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe në mbështetje të dispozitave materiale. Tutje paditësi pohon se e paditura i ka dhënë të njëjtat argumente të cilat janë prezantuar edhe në procedurën me shkrim pranë Shkallës së I-rë, ndërsa nuk ka paraqitur një provë të re ose ndonjë argument ligjor në procedurën ankimore. Këto pretendime janë të pa bazuara pasi që paditësi ka dorëzuar dëshmi të mjaftuara se ai ka punuar deri në privatizimin e ndërmarrjes me datë 22 maj 2007. Në këtë parashtresë paditësi i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Paditësi në këtë

parashtresë ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si epa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 13 korrik 2007, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Magjistranja" (në likuidim), një kërkesë për kompensim të 28 pagave të pagave të pa paguara duke mos specifikuar periudhën në shumë prej 6,272.64 euro, e cila kërkesë ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në, dhe po ashtu nuk ka qenë as në listën e pagave të NSH-së, për periudhën janar 2006-dhjetor 2007, andaj bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesa e pa mbështetur me prova, është refuzuar si e pavlefshme.

Paditësi në ankesën në shkallën e I-rë ka kërkuar kompensimin e pagave të papaguara për periudhën janar 2006-prill 2007, në shumë prej 6,272.64 euro, si dhe interesin ligjor, duke pohuar se Autoriteti i Likuidimit pa ndonjë bazë ligjore e ka refuzuar kërkesën si të pa pranueshme.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar dhe e ka ndryshuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, me arsyetimin se në bazë të provave të dorëzuara vërtetohet fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune në NSH prej 01 mars 1996 e deri me 13 prill 2007, kohë kur ka filluar likuidimi i NSH-së. Pastaj ky fakt vërtetohet edhe nga Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe Regjistri i punëtorëve, të cilën paditësi e ka ofruar si

provë. Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të përmbledhjes së pagave mujore për periudhën janar 2006-prill 2007, e nënshkruar nga Drejtori dhe Llogaritari i NSH-së, lartësia e shumës në emër të pagave të pa paguara është 3,016.13 euro. Tutje shkalla e I-rë konstaton se Drejtori i NSH-së Sh Sh dhe llogaritari i NSH-së A K në Deklaratën nën betim, kanë deklaruar se nën përgjegjësin e plotë morale, penale, dhe materiale ata kanë qenë kompetent dhe kanë nënshkruar listën e pagave të papaguara, dhe se ata janë të gatshëm në çdo kohë të dëshmojnë në të gjitha institucionet se këto lista të pagave paraqesin gjendjen e saktë të detyrimeve ndaj punëtorëve tek të gjitha njësit e NSH "Magjistrallja". Andaj duke u bazuar në këto prova shkalla e I-rë konstaton se paditësi në periudhën janar 2006-prill 2007 ka ofruar shërbime pune për NSH-në dhe se NSH-ja i ka mbetur borxh paditësit në shumë prej 3,016.13 euro, ndërsa e paditura nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e saj që është vërtetuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me parashtresën e datës 08 korrik 2022, të cilën paditësi e dorëzoi në DHPGJS si përgjigje ndaj Urdhrit, ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 13 prill 2007, Listat të pagave të punëtorëve të pa paguara për periudhën janar 2006, prill 2007, një akt përcjellës të Drejtorit të NSH-së për dërgimin e Listës së pagave në Zyrën rajonale të AKM-së, Deklaratë nën Betim të Drejtorit të NSH-së, kopja e letërnjoftimit, kontrata e punës së Drejtorit të NSH-së, një Referencë, dhe një Regjistër të punëtorëve.

Duke u bazuar në këto prova të cilat janë dorëzuar në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, shkalla e I-rë me të drejtë paditësit ja njehë të drejtën në pagesën e pagave të pa paguara për periudhën janar 2006-prill 2007, në shumë prej 3,016.13 euro, si dhe interesin ligjor prej 10% në shumë prej 301.61 euro.

Është e qartë se këto prova e vërtetojnë faktin se paditësi ka ofruar shërbime pune për NSH-në, dhe se NSH-ja për punën e kryer është e detyruar që paditësit, ti paguaj pagat për periudhën e cekur në shumë prej 3,016.13 euro, që duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me mbrojtje në ankesë dhe me ankesën e saj në shkallën e dytë pretendon se në bazë historikut të llogarisë së paditësit të siguruar

nga Banka Ekonomike, del që paditësi nuk ka qenë në listën e pagesave dhe se paditësi nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në. Këto pretendime lidhur me këto fakte të pohuara nga AKP-ja, nuk janë mbështetur me prova konkrete, prandaj për këtë arsye nuk janë marrë në konsideratë nga ana e Kolegjit të Apelit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro me datë 20 mars 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_